



KODI I ETIKËS I FSHN

1- Prezantimi

1.1. Garat ne sportin e notit bazohen në supozimin se të gjithë aktorët duhet të respektojnë rregullat dhe rregulloret ekzistuese dhe t'i japin rëndësinë më të madhe gares së ndershme dhe sjelljes korrekte. 1.2. Është e pamundur të përcaktohet me saktësi dhe në cdo rrethanë, tërësia e standardeve të sjelljes që pritet nga të gjitha palët e përfshira në aktivitetet e FSHN dhe eventet e saj, ose të listohen të gjitha situatat, të cilat do të përbënin një shkelje të Kodit të Etikës dhe që dotë çonin në sanksione disiplinore. Ekzistenca e këtij kodi shërben për t'u treguar pjesëmarrësve standardet e nevojshme të sjelljes. Nëse ndonjë pjesëmarrës në një ngjarje, apo aktivitet të FSHN-se, ka ndonjë dyshim sa i përket sjelljes që pritet prej tij, duhet të kontaktojë dhe t'i drejtohet zyrtarit momental të FSHN, ose organizatorit vendor, i cili drejton garen apo aktivitetin.

1.3. Mosmarrëveshjet që lindin gjatë një gare, apo aktiviteti do të zgjidhen në përputhje me rregullat ekzistuese të lojës si dhe me rregulloren e garës apo aktivitetit.

1.4. Kodi i Etikës është i aplikueshëm për: → zyrtarët e FSHN → organizatat anëtare → organizatorët, sponsorët → të gjithë garuesit dhe pjesëmarrësit e regjistruar në aktivitetet dhe garat e FSHN. Kodi i Etikës do të jete udhëheqës në veprimet që mund të ndërmerren kundër çdo personi (që do të thotë një individ apo organizatë), të cilët me dashje ose nga pakujdesia, shkelin rëndë rregullat dhe rregulloret e garave apo aktivitetetve, ose neglizhojnë në zbatimin e parimit të gares së ndershme.

2.Shkelja e etikës

Kodi i Etikës do të konsiderohet i shkelur nga një person apo organizatë që direkt ose indirekt:

2.1.Ofron, apo përpiqet për të ofruar, pranon ndonjë konsideratë apo ryshfet, me qëllimin për të ndikuar ne rezultatin e garave te notit apo zgjedhjet për organet e FSHN.

2.2. Në aspekte të tjera, vepron në kundërshtim me këtë kod.

2.2.1.Me rëndësi të veçantë në këtë drejtim janë, mashtrimi në administrimin e zyrave të FSHSN, ose zyrave të shoqates apo klubit, apo që ndikon ne klubet e tjera.



2.2.2. Drejtuesit apo anëtarët, të cilët me sjelljen e tyre nuk frymëzojnë besimin e nevojshëm, ose që në mënyra të tjera bëhen të padenjë për besimin.

2.2.3. Organizatorët, drejtorët e garave dhe aktivitetetve, gjyqtare apo zyrtarë të tjerë, të cilët nuk kryejnë funksionet e tyre në mënyrë të paanshme dhe të përgjegjshme.

2.2.4. Sjellje në mospërputhje me standardet dhe normat e mirësjelljes. Veprimet apo sjellja e keqe personale, e papranueshme për standartet normale sociale.

2.2.5. Mashtrimi, apo përpjekja për mashtrim, gjate garave dhe aktivitetetve në sportin e notit. Sjelljet e dhunshme, kërcënuese, apo sjellje të tjera të pahijshme gjatë, ose në lidhje me një garë apo aktivitete të sportit të notit.

2.2.6. Tërheqja e sportistëve nga gara pa arsye të vlefshme, ose pa informuar gjyqtarin e garës.

2.2.7. Shkelje të rënda ose të përsëritura të ligjeve dhe rregullave të sportit të notit sipas FINA, LEN dhe FSHN, ose rregulloreve të tjera të miratuara të garës .

2.2.8. Në çdo garë apo aktivitet të nivelit të lartë, sportistet, delegacionet apo ekipet, duhet të jenë të paraqitur në përputhje me kodin e veshjes të një standarti të lartë .

2.2.9. Sportistet apo anëtarët e delegacionit të tyre, nuk duhet të bëjnë akuza të pajustificuara ndaj anetareve të delegacioneve/ ekipeve/ të tjera, zyrtarëve, apo sponsorëve. Të gjitha protestat, apo ankesat, duhet t'i referohen drejtpërdrejt gjyqtarit/zyrtarit të emëruar, apo Drejtorit Teknik të garës/ aktivitetit.

2.2.10. Përveç kësaj, do të ndërmerren masa disiplinore, në përputhje me kodin e etikës së FiNA/LEN, në rastin e dukurive dhe ndodhjeve që dëmtojnë federatën apo anëtarët e saj, duke hedhur dritë negative dhe ndërmarë veprime të pajustificueshme e të pafavorshme, që dëmtojnë reputacionin e saj, si dhe veprimtarinë sportive të notit.

2.2.1. Çdo lloj sjelljeje që mund të dëmtojë ose të diskreditojë reputacionin e FSHN, garat, aktivitetet dhe organizimet e saj, pjesëmarrësit, sponsorët, apo që do të ndikojë në demtimin e reputacionit të saj dhe prishjes së emrit të mirë, do të ndëshkohet po ashtu, me masa disiplinore në përputhje me Kodin e Etikës.

3.Sanksionet

3.1.Shkeljet e Kodit të Etikës do të dënohen, qofshin ato akte, veprime ose një mosveprim, pavaresisht nëse ato janë kryer me dashje ose nga pakujdesia, qoftë nëse shkelja përbën një akt ose është tentuar të veprohet, si dhe pavaresisht nëse palët kanë vepruar si kryesore, pjesëmarrëse, bashkëpunëtorë apo nxitëse, apo thjesht kanë ndihmuar apo mbështetur.



3.2. Shkeljet e Kodit të Etikës janë të dënueshme me një ose më shumë prej masave të mëposhtme:
- paralajmërim - vërejtje - kthimi i shpërblimeve, ose gjobë - revokimin e titujve dhe rezultateve sportive - ndeshkim social; ndalimi për të marrë pjesë në një gare noti, apo në ndonjë aktivitet të lidhur me notin si sportist, gjyqtar, organizator, ose përfaqësues i federatës së notit; përjashtimin përkohësisht nga anëtarësia, zyra, ose veprimtaria.

3.3. Nëse është ndërmarë një sanksion , Komisioni i Etikës mund të shqyrtojë nëse për të baza plotësisht ose pjesërisht, të pezullojë zbatimin e sanksionit, nëse rrethanat përkatëse e lejojnë atë dhe në mënyrë të veçantë, sjelljet e mëparshme të personit të sanksionuar. Duke pezulluar ekzekutimin e sanksionit, Komisioni i Etikës mund të vendosi të nënshtrojë personin e sanksionuar në një periudhe prove ,nga gjashtë muaj deri në dy vjet. Nëse personi që përfiton nga një sanksion i pezulluar kryen ndonjë shkelje gjatë periudhës së provës, pezullimi automatikisht revokohet dhe aplikohet plotësisht sanksioni origjinal te cilit i shtohet sanksioni për shkeljen e re.

3.4. Sanksioni mund të vendoset duke marrë parasysh të gjithë faktorët relevantë në këtë rast, duke përfshirë moshën, protagonizmin në shkelje, apo ndihmën ndaj autorit, si dhe bashkëpunimin, motivin, rrethanat dhe shkallën e fajit të autorit.

3.5. Komisioni i Disiplinës vendos qëllimin dhe kohëzgjatjen e çdo sanksioni.

3.6. Sanksionet mund të jetë te kufizuara në një zonë gjeografike te caktuar dhe për një ose më shumë gara të veçanta (duke filluar nga data).

3.7. Përveç nëse specifikohet ndryshe, sanksioni mund të rritet, sipas nevojës, nëse shkelja është e përsëritur.

3.8. Aty ku ka qenë e angazhuar më shumë se një shkelje, sanksioni do të bazohet në shkeljen më të rëndë, në përshtatje dhe në varësi të rrethanave të veçanta. Në këto raste, gjatë përcaktimit të shumës së gjobës, Komisioni i Disiplinës nuk është i detyruar t'i përmbahet gjobës maksimale të dhënë më sipër. 3.9. Me kërkesën e nje trupi gjykues, Komisioni i Disiplines, kur ai është emëruar, mundet (menjëherë) të marrë masa të përkohshme (p.sh. sanksione të përkohshme), në qoftë se është kryer një shkelje e dukshme e nje pike të Kodit të Etikës dhe vendimi mbi çështjen kryesore, i marë paraprakisht, mund te mos jete i mjaftueshem. Komisioni i Disiplinës mund të mare masa të përkohshme për parandalimin e ndërhyrjeve në zbardhjen e të vërtetës. Masat e përkohshme mund të jenë të vlefshme për një periudhë maksimale prej 75 ditësh. Në rrethana të jashtëzakonshme, masat e përkohshme mund të zgjaten nga Komisioni i Disiplinës për një periudhë shtesë, që mos tejkalojë 45 ditë. Kohëzgjatja e sanksioneve të përkohshme do të merret parasysh në vendimin përfundimtar.



FEDERATA SHQIPTARE E NOTIT
ALBANIAN SWIMMING FEDERATION



Address: Parku Olimpik
TIRANA-ALBANIA

Web: www.fshn.org.al
E-mail: info@fshn.org.al

4.Procedurat administrative

4.1. Shkelja e rregullave të këtij kodi nga ndonjë zyrtar i Federatës do t'i raportohet Sekretariatit të FSHN.

4.2. Shkelja e rregullave të këtij kodi nga çdo person duhet të raportohet dhe të vendoset nga Komisioni i Disiplinës së FSHN dhe/ ose, nga organi vendim – marrës, Komiteti Drejtues dhe Asambleja e Pergjithshme.

4.3. Procedurat do të regjistrohen me shkrim. Arsyetimi duhet të jepet për çdo vendim të marë, në formë të shkruar.

4. 4. Kunder cdo vendimi apelohehet ne KAS, Keshilli Arbitrazhit Sportiv.